

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8290  
E enjte, 30 prill 2026  
Çmimi 0.50 €

Shqipëria firmos me  
ShBA-në marrëveshje  
për gazin në vlerë prej  
6 miliardë dollarësh

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)




facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## ZGJEDHJET E REJA, MË 31 MAJ APO 7 QERSHOR?

FAQE 4-5



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është në pritje të vendimit për caktimin zyrtar të datës për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, pasi Kuvendi dështoi ta zgjedhë presidentin e ri brenda afatit, duke e zhytur vendin në një krizë të re

politike. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë për "Epokën e re" se zgjedhjet do të organizohen me afate të shkurtra kohore dhe në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Ushtruesja e detyrës së presidentit,

Albulena Haxhiu, pritet t'i ftojë partitë politike në takim për të biseduar për datën e parapëlqyer për mbajtjen e zgjedhjeve. Janë vetëm dy data të mundshme për mbajtjen e zgjedhjeve të reja të parakohshme sipas procedurave ligjore: 31 maj dhe 7 qershor

### OPINION

**KUSHTETUTA NUK LEJON  
BAJRAKTARIZËM DHE  
NARCIZËM POLITIK** F. 6

Shkruan:  
Prof. dr. Fejzulla  
BERISHA



### AKTUALE



**NËNSHKRUHET MARRËVESHJA  
PËR NDËRTIMIN E ANIJEVE  
LUFTARAKE NË SHQIPËRI** F. 2

**SHBA-ja E ZGJERON PRANINË  
USHTARAKE NË LINDJEN E  
MESME TEKSA ARMËPUSHIMI ME  
IRANIN PO LËKUNDET** F. 2

### EKONOMI



**OEK-u KËRKON VEPRIME  
URGJENTE PËR PËRFSHIRJEN E  
KOSOVËS NË PROJEKTET  
RAJONALE TË GAZIT** F. 8

**GUVERNATORI ISMAILI:  
ANGAZHIMI I BQK-SË MBETET I  
PALËKUNDUR NË FORCIMIN E  
STABILITETIT FINANCIAR** F. 8



**RREZIKU  
I "SKENARIT  
BULLGAR"  
PËR  
KOSOVËN** F. 3



**MË SHITRENJTË  
SE VITIN E KALUAR,  
PRODHIMET  
BUJQËSORE RRITEN  
PËR 5.8 %  
NË TRE MUAJT  
E PARË TË VITIT** F. 8

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mok: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

### SPORT

**NIS ZYRTARISHT GARIMI I VAJZAVE  
NË KUADËR TË EDICIONIT TË DYTË  
TË LIGËS SË SHKOLLAVE** F. 11

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR NDËRTIMIN E ANIJEVE LUFTARAKE NË SHQIPËRI

TIRANË, 29 PRILL - Shqipëria dhe Italia kanë nënshkruar marrëveshje për prodhimin e anijeve luftarake jo vetëm për ushtrinë shqiptare, por dhe për shtetet aleate. Marrëveshja u firmos mes kompanisë shtetërore shqiptare "Kayo", e cila operon në industrinë e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe kompanisë italiane "Fincantieri", që është një ndër ndërtueset më të mëdha të anijeve tregtare dhe ushtarake në Evropë.

Të dyja kompanitë do të krijojnë një shoqëri të re për të prodhuar anije luftarake në Shqipëri, në kantierin e Pashalimanit, në jug të vendit. Sipas marrëveshjes, në këtë kantier të ri do të punësohen afër 400 persona. Kantieri do të transformohet në një aset kyç për Forcën Detare në Vlorë, me fokus në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e njësive deri në 80 metra gjatësi dhe 800 tonë kapacitet.

Sipas Ministrisë së Mbrojtjes të Shqipërisë, kompania "Kayo" do ta vendosë në dispozicion kantierin dhe do të investojë në modernizimin

infrastrukturës, ndërsa Fincantieri do të sjellë ekspertizë dhe trajnim, furnizimin me materiale dhe mbështetje teknologjike për një proces prodhimi modern.

Ministria shqiptare theksoi se ky është një plan ambicioz prej 1.2 miliard eurosh.

Pashalimani është baza më e rëndësishme e Forcës Detare Shqiptare dhe ndodhet në Gjirin e Vlorës në jug të Shqipërisë. Funksionon si bazë ushtarake detare dhe kantier riparimi dhe ndërtimi anijesh. Në kohën e Luftës së Ftohtë ishte një nga bazat më të rëndësishme në Mesdhe për Bashkimin Sovjetik. Pas viteve '90 u përdor nga Forcat Detare Shqiptare dhe u riorganizua me ndihmë ndërkombëtare.

Të pranishëm në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes ishin edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, ambasadori i Italisë në Tiranë, Marco Alberti, dhe përfaqësues të kompanive që operojnë në industrinë ushtarake në dy vendet.

Kryeministri Rama e cilësoi

marrëveshjen si një moment u rëndësishëm për të ardhmen e sigurisë dhe ekonomisë së Shqipërisë - shtetit anëtar të NATO-s. "Ne [Shqipëria] do të jemi të parët që do të përfitojmë nga produktet e shoqërisë në mënyrë konkrete nga dy anijet e para që do të ndërtohen për Forcat tona të Armatosura dhe që do të çojnë në shtatë numrin total të flotës sonë... dhe më pas sigurisht prodhimi do të vazhdojë më tej për të eksportuar këto anije, aty ku sigurisht është e qartë që teknologjia e re dhe inovacioni që do të shoqërojë këtë rugëtim, do të implementohet", tha ai.

Rama shtoi se zhvillimet e fundit e bëjnë të domosdoshëm investimin në industrinë ushtarake. "Shpresoj që bota të përmirësohet dhe që luftërat të përfundojnë, por ndërkohë Shqipëria është shumë e vogël për të vendosur të ardhmen e botës dhe fatin e lojës së shahut gjeopolitike, por duhet të përshtatemi. Duhet të përshtatemi sigurisht në të vogël tonë për të pasur një mbrojtje dinjitoze dhe për të



pasur gjithçka që nevojitet për të qenë në lartësinë e një vendi të vogël, por krenar në aleancën transatlantike ku ne bëjmë pjesë", u shpreh kryeministri shqiptar.

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, theksoi se ky bashkëpunim e bën Shqipërinë një bazë të re evropiane të "Fincantierit" për anijet e vogla dhe të mesme. "Modeli i biznesit është që mbi 90 % e klientëve janë ndërkombëtarë, klientë ekzistues të "Fincantierit", tha ai. Më 10 prill qeveria shqiptare mori vendimin për ta

autorizuar shoqërinë shtetërore, "Kayo", për të lidhur marrëveshje për prodhimin dhe tregtimin e dronëve luftarakë dhe mjeteve lundruese ushtarake dhe civile në Shqipëri.

Ndërkaq, pak ditë më parë Ambasada Amerikane në Tiranë në një njoftim për medie në lidhje me vizitën e ambasadorit të Shteteve të Bashkuara në NATO, Matthew Whitaker, në Shqipëri theksoi se u diskutuan "afësinë e Shqipërisë për t'u bërë një nyje logjistike e NATO-s në rajon".

## SHBA-ja E ZGJERON PRANINË USHTARAKE NË LINDJEN E MESME TEKSA ARMËPUSHIMI ME IRANIN PO LËKUNDET

WASHINGTON, 29 PRILL - Derisa armëpushimi i saj me Iranin po dobësohet, Shtetet e Bashkuara po e zgjerojnë dukshëm praninë e tyre ushtarake në Lindjen e Mesme, duke i dhënë vetes mundësinë për ta përshkallëzuar konfliktin dymujor.

Ushtria amerikane e dërgoi më 24 prill në rajon aeroplanmbajtësen e tretë sulmuese, së bashku me mijëra trupa elitare.

Ky është grumbullimi më i madh ushtarak amerikan në rajon që nga pushtimi i Irakut në vitin 2003.

Armëpushimi, pasi hyri në fuqi më 8 prill, e ndali një luftë të kushtueshme që ka tronditur tregjet ndërkombëtare të energjisë dhe ka përmbysur ekonominë globale.

Por, Uashingtoni dhe Teherani e kanë akuzuar njëri-tjetrin për shkelje të armëpushimit, ndërsa përpjekjet për të arritur marrëveshje për përfundimin e luftës kanë ngecur.

Presidenti amerikan Donald Trump tha se Shtetet e Bashkuara e kanë përdorur ndërprerjen e luftimeve për t'u "rifurnizuar" dhe paralajmëroi se ushtria amerikane është "e gatshme për të vepruar" nëse përpjekjet për paqe dështojnë.

Trumpi më parë ka kërcënuar se do ta shkatërrojë

infrastrukturën civile të Iranit, nëse nuk arrihet një marrëveshje.

Ekspertët thonë se zgjerimi i pranisë ushtarake amerikane ka dy qëllime: t'i dërgojë mesazh politik Teheranit dhe t'i japë Trumpit mundësi për ta zgjeruar shkallën e veprimeve ushtarake kundër republikës islamike. "Synimi është të rritet besueshmëria e kërcënimeve amerikane dhe, rrjedhimisht, ndikimi i saj në bisedime", tha Farzan Sabet, ekspert për Iranin në Institutin e Studimeve të Avancuara në Gjenevë. "Gjithashtu, synimi është që ShBA-ja të jetë e pozicionuar më mirë, nëse rifillojnë luftimet, për ta dobësuar më tej Iranin dhe për ta rihapur Ngushticën e Hormuzit", tha ai.

Fushata e bombardimeve ShBA - Izrael, që nisi më 28 shkurt, e ka shkatërruar shumë ushtrinë iraniane, ka shfarosur një pjesë të madhe të udhëheqjes së Iranit dhe e ka rënuar infrastrukturën jetike. Megjithatë, Teherani ende beson se po e fiton luftën. Teokracia iraniane ka mbijetuar dhe ka fituar një kartë të re të fuqishme: kontrollin e Ngushticës së Hormuzit, rrugës jetike për furnizimin global me naftë dhe gaz.

Në përgjigje të mbylljes efektive të Ngushticës së Hormuzit nga Irani, Shtetet e Bashkuara kanë



vendosur një bllokadë detare ndaj porteve dhe anijeve të këtij vendi që nga 13 prilli.

Derisa ky vendim e ka rritur trysinë mbi ekonominë tashmë të goditur të Iranit, bllokada ende nuk e ka detyruar Teheranin ta pranojë një marrëveshje paqeje sipas kushteve amerikane.

Duke bartur mbi 5 000 trupa elitare, aeroplanmbajtësja USS George H.W. Bush i rrit ndjeshëm kapacitetet ushtarake

amerikane në rajon. E aftë të mbështesë mbi 80 avionë, kjo aeroplanmbajtëse furnizohet nga reaktorë bërthamorë. Ajo u bashkohet dy aeroplanmbajtëseve të tjera: USS Abraham Lincoln, e vendosur në Detin Arabik në jug të Iranit që nga fillimi i luftës, dhe USS Gerald R. Ford, anija më e fuqishme transportuese e marinës amerikane.

Përveç dërgimit të aeroplanmbajtëses së tretë në

Lindjen e Mesme, ushtria amerikane ka zhvendosur edhe mijëra trupa shtesë në rajon në javët e fundit.

Mijëra marinsa, parashutistë dhe marinarë të tjerë pritet të mbërrijnë deri në fund të muajit. Zyrtarët iranianë nuk kanë komentuar publikisht për zgjerimin e pranisë ushtarake amerikane, por ekspertët thonë se Teherani beson se Shtetet e Bashkuara po përgatiten për rifillimin e luftimeve.

# RREZIKU I 'SKENARIT BULLGAR' PËR KOSOVËN

**Kosova po hyn në një cikël zgjedhjesh të përsëritura, duke ngritur paralelizma me përvojën bullgare të bllokimeve politike. Analistët thonë se kriza ngadalëson reformat kyçe dhe krijon një kosto të vazhdueshme financiare për buxhetin e shtetit, pa asnjë garanci se zgjedhjet e reja do të sjellin stabilitet politik**

PRISHTINË, 29 PRILL - Në ditën kur u bënë katër muaj nga zgjedhjet e fundit parlamentare, u konfirmua se Kosova do të shkojë sërish në zgjedhje.

Një rikthim i shpejtë në kutitë e votimit, jo si rezultat i një zgjedhjeje politike, por si pasojë e një krize që politikëbërësit nuk arritën ta zgjidhin. "Kjo është papjekuria e tyre, si karshi shtetit, ashtu edhe karshi stuhisë së zhvillimeve që kanë përshkuar botën", vlerëson për Radion Evropa e Lirë analisti politik, Ilir Deda.

Më 7 qershor - më së largu - qytetarët e Kosovës do të dalin sërish në zgjedhje parlamentare, për herë të tretë brenda 16 muajsh.

Ky proces u bë i pashmangshëm më 28 prill, vetëm katër muaj pas zgjedhjeve të 28 dhjetorit, kur deputetët dështuan ta zgjedhin presidentin, duke aktivizuar automatikisht afatin kushtetues që e çon vendin në zgjedhje brenda 45 ditësh.

Partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, akuzoi opozitën për bojkotim të qëllimshëm të seancave, ndërsa partitë opozitare fajësuan pushtetin për mungesë bashkëpunimi dhe për përpjekje për përqendrim të pushtetit në një dorë të vetme. "Kosova, për të pasur president të ri, duhet të ketë opozitë të re. Opozita është e vjetër. Kjo opozitë mund të sjellë ndonjë fytyrë të re, por zanatin dhe karakterin e ka të vjetër, andaj edhe është në rënie të lirë", deklaroi kryeministri Albin Kurti, njëherësh kryetar i IV-së, në seancën e fundit të legjislaturës së dhjetit.

Dy partitë kryesore opozitare, PDK-ja dhe LDK-ja, e mirëpritën shkuarjen në zgjedhje të reja, ndonëse, sipas kryetarit të LDK-së, ato u imponuan nga pushteti, i cili me shumicën prej 51 përqindësh kërkoi "nënshtrim" politik. "Tani është koha për bashkimin e njerëzve të mirë të këtij vendi, që duan një Kosovë normale, pa dramë, pa propagandë...", shkroi Lumir Abdixhiku në Facebook.

## Një krizë e përsëritur, jo episod i ri

Kjo situatë nuk është e re për Kosovën. Një skenar i ngjashëm u përsërit menjëherë pas zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025, kur Kuvendi mbeti i pakonstituar për muaj të tërë dhe, në fund, formimi i qeverisë dështoi. Edhe atëherë, përgjegjësia u nda mes palëve, me akuzë që kalonin nga njëra te tjetra.

Për Dedën situata nuk është më episod i izoluar, por një model që po merr formë. Ai paralajmëron se Kosova po i afrohet një skenari të ngjashëm me Bullgarinë, e cila



në pesë vjetët e fundit ka kaluar nëpër shtatë cikle të njëpasnjëshme zgjedhjesh, pa prodhuar stabilitet institucional. "Nuk pritej që pas zgjedhjeve të 28 dhjetorit, kur Lëvizja Vetëvendosje i fitoi 51 për qind të votave, ne të mbërrinim në këtë situatë", thotë ai.

Në analizën e tij, problemi nuk qëndron te sistemi politik, por te mënyra se si ai përdoret. Kosova, thotë Deda, ka një kornizë institucionale të avancuar, por ajo po shndërrohet në instrument përplasjeje, në vend se të shërbejë si bazë stabiliteti. Përgjegjësinë kryesore ai ia atribuon partisë më të madhe, e cila, siç thotë, ka pasur mundësi reale për të ndërtuar qëndrueshmëri institucionale. Deda konsideron se kjo krizë ka qenë lehtë e shmangshme. "Partitë kanë mundur të diskutojnë se çfarë presidenti duan: një figurë që ka filluar aktivitetin politik që në vitet '90, duke reflektuar rrugëtimin dhe shtetndërtimin e Kosovës; një figurë të lidhur me UÇK-në, si kundërreagim ndaj procesit në Hagë; apo një figurë që sheh nga e ardhmja", thotë Deda.

Në vend të kësaj ai konsideron se debati u shndërrua në një lojë politike për ta drejtuar gishtin nga fajtorët dhe për të "fabrikuar alibi" për shmangien e përgjegjësisë.

Deda paralajmëron se, duke qenë në këtë trajektore, Kosova rrezikon të mbetet jashtë zhvillimeve të rëndësishme globale, ndërsa perceptimi për të si shtet i brishtë mund të ketë pasojë afatgjatë si në raport me partnerët ndërkombëtarë, po ashtu edhe me besimin qytetar. "Unë vetëm shpresoj që pas zgjedhjeve të reja të ketë një maturim të politikës dhe forcim

të kulturës së konsensusit", thotë Deda. Në të kundërtën, sipas tij, cikli i zgjedhjeve mund të mos ndalet.

## Mes legjitimitetit dhe "kohës së humbur"

Radio Evropa e Lirë kërkoi koment nga Departamenti Amerikan i Shtetit dhe Bashkimi Evropian për dështimin e Kosovës në zgjedhjen e presidentit dhe shkuarjen në zgjedhje të reja, si dhe për pasojat që kjo mund të ketë në stabilitetin politik të vendit, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk mori përgjigje.

Toby Vogel, analist në Këshillin për Demokratizimin e Politikave në Bruksel, thotë se zgjedhjet e parakohshme mund të shihen si "kohë e humbur", pasi ka gjasa të prodhojnë një rezultat politik të ngjashëm me atë të mëparshmin. Megjithatë, ai thekson se ky është një proces i paraparë me Kushtetutë, ndaj është edhe legjitim, edhe demokratik. "Si një qeveri e mirëfilltë demokratike, qeveria Kurti dhe autoritetet e tjera, Parlamenti e kështu me radhë, po e ndjekin procedurën kushtetuese", vlerëson Vogel për Radion Evropa e Lirë.

Nga perspektiva evropiane, ai thotë se BE-ja dhe disa shtete anëtare nuk po tregojnë vullnet politik për ta çuar Kosovën përpara në procesin e integritetit, duke u fshehur pas narrativit të "paqëndrueshmërisë së brendshme". "Edhe kur Kosova gëzonte stabilitet të paprecedent të brendshëm nën kryeministrin Kurti, BE-ja nuk bëri asnjë përparim as në dialogun me Serbinë dhe as në procesin e anëtarësimit - gjë që tregon se

narrativi për paqëndrueshmëri është një justifikim i pabazë, që fsheh mungesën e vullnetit politik në Bruksel dhe në shtetet kyçe anëtare", shton Vogel.

## Kosto përtej politikës

Kriza në Kosovë nuk kufizohet vetëm në politikë. Ajo ndikon drejtpërdrejt edhe në ritmin e vendimmarrjes shtetërore. Sipas Naim Jakajt nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, pasoja e parë është paralizimi i procesit legjislativ. Në mungesë të një Kuvendi funksional nuk miratohen ligje të reja dhe ngadalësohen reformat kyçe, përfshirë ato që lidhen me sundimin e ligjit dhe integritetin evropian.

Një tjetër problem, sipas tij, është edhe mungesa e mbikëqyrjes parlamentare ndaj qeverisë - një element thelbësor në një sistem demokratik. Kjo situatë, thekson Jakaj, e ul ndjeshëm nivelin e llogaridhënies dhe transparencës në vendimmarrje. "Qeveria në detyrë ka mandat të kufizuar dhe nuk mund të ndërmarrë vendime strategjike afatgjata, duke e lënë vendin në një gjendje stagnimi institucional. Në thelb, krijohet një vakum institucional, ku shteti funksionon minimalisht, por nuk zhvillohet", thotë Jakaj për Radion Evropa e Lirë.

Ai nënvizon se mungesa e një qeverie me mandat të plotë reflektohet drejtpërdrejt edhe në planin ndërkombëtar. Sipas tij, kjo mund të shkaktojë vonesa në procese të rëndësishme, si aplikimi për anëtarësim në Këshillin e Evropës apo përmbushja e obligimeve në kuadër të Planit të Rritjes të Bashkimit Evropian.

## Fatura financiare e zgjedhjeve

E përtej dimensionit politik e ligjor, kriza prodhon edhe një barrë shtesë - atë financiare - pasi çdo proces i ri zgjedhor nënkupton shpenzime të reja për buxhetin e shtetit.


Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, thotë për Radion Evropa e Lirë se viti 2026 nuk është paraparë si vit zgjedhor, ndaj në buxhetin vjetor të institucionit nuk janë ndarë mjete për zgjedhje të parakohshme.

Në rrethana të tilla, KQZ-ja detyrohet t'i drejtohet Qeverisë së Kosovës me kërkesë për fonde, në mënyrë që të mbulojë kostot e organizimit të procesit.

Si pikë krahasimi, Elezi përmend zgjedhjet e fundit të 28 dhjetorit, për të cilat ishte planifikuar një buxhet prej 11.5 milionë eurosh, ndërsa shpenzimet reale arritën në rreth 7 milionë euro, sipas të dhënave ende jopërfundimtare. Në ato zgjedhje, mbi 2 milionë shtetas të Kosovës, brenda dhe jashtë vendit, kishin të drejtë vote - një shifër që pritet të mbetet e ngjashme edhe në zgjedhjet e ardhshme.

Pjesëmarrja ishte rreth 45 për qind, por një nivel i tillë nuk është i garantuar pasi, siç thotë Jakaj, zgjedhjet e shpeshta krijojnë "lodhje" te votuesit.

Ndryshe prej tij, Deda e sheh fokusin diku tjetër: jo te rënia e pjesëmarrjes, por te mënyra se si qytetarët do ta lexojnë dhe gjykojnë vetë situatën politike. "Test i zgjedhjeve është pjekuria e popullit të Kosovës - nëse qytetarët e Kosovës do ta ndëshkojnë një sjellje të tillë të partive apo do ta miratojnë atë", përfundon Deda.



# ZGJEDHJET E REJA, MË 31 MAJ APO 7 QERSHOR?

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është në pritje të vendimit për caktimin zyrtar të datës për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, pasi Kuvendi dështoi ta zgjedhë presidentin e ri brenda afatit, duke e zhytur vendin në një krizë të re politike.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë për "Epokën e re" se zgjedhjet do të organizohen me afate të shkurtra kohore dhe në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Ushtruesja e detyrës e presidentit, Albulena Haxhiu, pritet t'i ftojë partitë politike në takim për të biseduar për datën e parapëlqyer për mbajtjen e zgjedhjeve. Janë vetëm dy data të mundshme për mbajtjen e zgjedhjeve të reja të parakohshme sipas procedurave ligjore: 31 maj dhe 7 qershor

**EPOKA  
ERE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 29 PRILL** - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) tani ka pak më shumë se një muaj kohë për t'i përgatitur dhe zhvilluar zgjedhjet e reja të parakohshme parlamentare, të tretat radhazi brenda rreth një vitit e gjysmë. KQZ-ja është në pritje të vendimit për caktimin zyrtar të datës për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë për "Epokën e re" se zgjedhjet do të organizohen me afate të shkurtra kohore dhe në

përputhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. "Meqenëse këto janë zgjedhje të parakohshme, organizimi i tyre bëhet me afate të shkurtra kohore dhe një nga vendimet e para të KQZ-së për këtë proces zgjedhor do të jetë ndryshimi i afateve kohore të aktiviteteve zgjedhore apo përshtatja e tyre sipas nevojës dhe në pajtim me rrethanat. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme ia jep të drejtën KQZ-së që afatet kohore të aktiviteteve zgjedhore të përshtaten me ditët në dispozicion të KQZ-së për organizimin e këtyre zgjedhjeve", ka deklaruar Elezi. Me planin e aktiviteteve, Elezi

ka thënë se KQZ-ja rregullon çështjet mbi të cilat ndërtohet i gjithë procesi zgjedhor dhe që kanë të bëjnë me votuesit, subjektet politike dhe vëzhguesit. "Pra, këtu përcaktohen afati për partitë politike për të formuar koalicione dhe deklaruar mospjesëmarrjen në zgjedhje, afatin për subjektet politike për t'u certifikuar e për ta dorëzuar listën e kandidatëve për deputetë dhe periudhën e fushatës zgjedhore. Po me anë të këtij plani, KQZ-ja cakton edhe kohën për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës, votimin përmes postës dhe në përfaqësi diplomatike, si dhe

regjistrimin e votuesve me nevoja të veçanta. Pjesë e këtij plani është edhe vendosja e afateve për akreditimin e vëzhguesve dhe medieve", ka thënë Elezi.

Zgjedhjet e reja vijnë pasi Kuvendi dështoi ta zgjedhë presidentin e ri brenda afatit, duke e zhytur vendin në një krizë të re politike.

Kuvendi kishte afat deri në mesnatën e së martës për ta zgjedhur kreun e shtetit, pasi mandati i presidentes Vjosa Osmani përfundoi në fillim të prillit. Por, kryeministri Albin Kurti dhe partitë opozitare nuk arritën marrëveshje për zgjedhjen e presidentit të ri.

## Cilat janë data e mundshme për datën e zgjedhjeve?

Janë vetëm dy data të mundshme për mbajtjen e zgjedhjeve të reja të parakohshme sipas procedurave ligjore: 31 maj dhe 7 qershor, sipas Melos Kolshit, hulumtues në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD). Për shkak se presidenti nuk u zgjodh brenda afatit prej 34

ditësh që Gjykata Kushtetuese e kishte vendosur në një aktgjykim në mars, Kuvendi u shpërnda automatikisht më 28 prill, shpjegon Kolshi për Radion Evropa e Lirë (REL).

Përndarja e Kuvendit, sipas tij, nënkupton nisjen e menjëhershme të procesit drejt zgjedhjeve të reja të cilat duhet të mbahen brenda 45 ditëve të ardhshme. "Në këtë mënyrë, pas dështimit të Kuvendit për ta zgjedhur presidentin, krijohet një rend i detyrueshëm veprimesh: së pari, shpërndarja automatike e Kuvendit si pasojë kushtetuese; së dyti, aktivizimi i kompetencës së ushtrueses së detyrës së presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve; dhe, së treti, organizimi i zgjedhjeve të parakohshme brenda afateve të përcaktuara ligjore", thotë Kolshi për REL-in.

Si caktohet data e zgjedhjeve?

Ushtruesja e detyrës e presidentit, Albulena Haxhiu, tani duhet t'i ftojë partitë politike në takim për të biseduar për datën e parapëlqyer për mbajtjen e zgjedhjeve. Këtë herë ato do ta kenë më të lehtë të zgjedhin,

sepse kanë vetëm dy opsione: 31 majin, ose 7 qershorin. Pas një takimi të tillë dhe pajtueshmërisë për datën e zgjedhjeve, Haxhiu duhet ta shpallë zyrtarisht datën e zgjedhjeve të parakohshme dhe ajo ka kohë deri në fund të javës së ardhshme për ta bërë këtë. “Ky vendim duhet të merret brenda një afati prej 10-ditësh nga dita e shpërndarjes së Kuvendit, ndërsa data e zgjedhjeve duhet të jetë në përputhje me kufijtë kohorë të përcaktuar me ligj, përkatësisht zgjedhjet nuk mund të mbahen më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë nga dita e shpërndarjes”, tregon Kolshi.

### Pse vetëm dy data të mundshme?

Gjithë këto zhvillime kanë bërë që të mos ketë shumë opsione. Përveç afatit kohor prej 30 deri në 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit, ekziston edhe një praktikë zgjedhore në vend që lë kaq pak hapësirë: mbajtja e zgjedhjeve në një ditë fundjave. “Gjithashtu, ligji kërkon që zgjedhjet të mbahen në një ditë të diel, duke respektuar praktikën dhe standardet zgjedhore. Në këtë rast konkret, duke pasur parasysh se data e shpërndarjes së Kuvendit është 28 prill, datat e mundshme për mbajtjen e zgjedhjeve janë 31 maj dhe 7 qershor”, shpjegon Kolshi. Sipas Kolshit, ky

zhvillim përfaqëson një shembull tipik të mënyrës se si Gjykata Kushtetuese, përmes interpretimit të saj, ka saktësuar dhe operacionalizuar normat kushtetuese, duke krijuar një mekanizëm të qartë dhe automatik për zgjidhjen e krizave institucionale. “Njëkohësisht e ka kufizuar hapësirën për ndërhyrje diskrecionale nga ana e ushtrueses së presidentit në këtë rast, po ashtu ka kufizuar mundësitë për ndonjë abuzim eventuale me të drejtat e afatit nga ndonjë subjekt”, përfundon ai.

### Shkuarja në zgjedhje të reja prodhon pasoja institucionale

Eugen Cakolli nga KDI ka theksuar se tashmë që Kuvendi konsiderohet i shpërndarë me efekt kushtetues, ushtruesja e detyrës së presidentit ka afat 10 ditë për ta caktuar datën e zgjedhjeve pas konsultimit me partitë politike dhe KQZ-në. “Zgjedhjet e parakohshme duhet të mbahen brenda 45 ditëve, por jo më herët se 30 ditë nga shpërndarja e Kuvendit. Megjithatë, afati 10-ditor i u. d. presidentes për shpalljen e zgjedhjeve nuk e shtyn afatin e fundit për mbajtjen e tyre - që mund të jetë vetëm 31 maji ose 7 qershori”, thotë Cakolli, duke shtuar se shkuarja në zgjedhje të reja prodhon pasoja institucionale.

## PDK-ja i kërkon u. d. presidentes emërimin e anëtarit të dytë në KQZ

Anëtari i Kryesisë së PDK-së, Betim Gjoshi, ka thënë se tashmë Kosova po hyn në zgjedhje dhe ushtruesja e detyrës së presidentes së Kosovës, duhet që, përveç shpalljes së datës së zgjedhjeve, ta nënshkruajë edhe dekretin për emërimin e anëtarit të dytë të Partisë Demokratike të Kosovës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Ai ka thënë se mosëmërimi i përfaqësuesit të PDK-së do të ishte shkelje e Kushtetutës së Kosovës, por edhe dëmtrim i përfaqësimit

opozitar në institucionin e zgjedhjeve dhe rrezikim i legjitimitetit të zgjedhjeve. “Zgjedhjet e 28 dhjetorit nuk janë mbajtur për KQZ, por për Kuvendin e Kosovës, në të cilin kanë arritur të hyjnë 4 grupe parlamentare. Andaj, në rrethana të tilla, meqenëse pas këtyre zgjedhjeve në Kuvend ishin vetëm 4 grupe parlamentare shqiptare, pra në mungesë të numrit të mjaftueshëm prej 6 grupeve, anëtarët shtesë emërohen nga grupet më të mëdha parlamentare, që në këtë rast

janë Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës”, ka shkruar Gjoshi në “Facebook”, duke theksuar se Kosova ka nevojë për zgjedhje të lira, të drejta dhe të pranura nga të gjithë aktorët politikë dhe qytetarët, e jo zgjedhje legjitimiteti i të cilave do të vihej në pikëpyetje. “Askush nuk duhet ta shfrytëzojë KQZ-në për të arritur qëllime politike përmes përfaqësimit jokushtetues. Askush nuk mund ta përdorë KQZ-në për përfitime politike në kundërshtim me rendin kushtetues”, ka thënë Gjoshi.

“Me shpërndarjen e Kuvendit ka përfunduar edhe mandati i qeverisë. Nga mesnata e mbrëmshme qeveria konsiderohet në dorëheqje dhe veprimtaria e saj kufizohet vetëm në punë të domosdoshme dhe të planifikuara sipas buxhetit (që ka pasur mangësi të shumta) dhe planit vjetor (që nuk është publik). Qeveria nuk mund të propozojë më projektligje të reja, strategji apo dokumente të tjera politike, nuk mund të iniciojë emërimin në pozita

publike dhe nuk mund të ndërmarrë marrëveshje ndërkombëtare që kërkojnë ratifikim nga Kuvendi. Projektligjet në procedurë parlamentare rikthehen në pikën zero. Në Kuvend kanë qenë rreth 30 projektligje në shqyrtim. Me shpërndarjen legjislativë këto nuk vazhdojnë më tutje, meqë i gjithë procesi legjislativ duhet të rifillojë nga pika zero pas konstituimit të Kuvendit dhe formimit të qeverisë së re. Raportet e institucioneve të pavarura

mbesin pa shqyrtim. Asnjë raport vjetor i institucioneve të pavarura që i raportojnë Kuvendit nuk është miratuar. Me mungesën e Kuvendit funksional, këto raporte mbesin pezull dhe nuk trajtohen deri në krijimin e legjislaturës së re, duke pamundësuar llogaridhënien. Pra, deri në mbajtjen e zgjedhjeve dhe krijimin e institucioneve të reja - që do të marrë kohë të paktën tre-katër muaj - shteti do të jetë në pauzë”, ka theksuar Cakolli.



# KUSHTETUTA NUK LEJON BAJRAKTARIZËM DHE NARCIZËM POLITIK

**- Epërsia e rendit kushtetues ndaj pushtetit dhe kufijtë juridikë të legjitimitetit politik**



Shkruan: Prof. dr. Fejzulla BERISHA

Në doktrinën moderne të së drejtës kushtetuese qëndron një parim themelor dhe i pakontestueshëm: pushteti nuk qëndron mbi Kushtetutën, por i nënshtrohet asaj si norma më e lartë juridike që e krijon, e legjitimon dhe e kufizon atë. Ky parim nuk është thjesht formulim teorik; është themeli funksional mbi të cilin ndërtohet çdo rend demokratik bashkëkohor. Ky kuptim buron nga parimi i supremacisë kushtetuese (Constitutional supremacy), sipas të cilit Kushtetuta është norma më e lartë juridike në hierarkinë e rendit juridik dhe çdo akt i pushtetit publik duhet të jetë në përputhje me të. Nëse pushteti del jashtë këtij kufiri, ai humb jo vetëm vlefshmërinë juridike, por edhe legjitimitetin demokratik.

## Kushtetuta si kufi, jo si instrument i pushtetit

Kushtetuta nuk është mjet i shumicës politike, por kufi i saj. Ajo nuk ekziston për të realizuar vullnetin e përkohshëm politik, por për të garantuar stabilitetin juridik dhe mbrojtjen e qytetarit nga arbitrariteti shtetëror. Në këtë kuptim, çdo tentativë për ta vendosur vullnetin politik mbi normën kushtetuese përbën deformim të shtetit juridik (Rule of law). Kjo është pikërisht pika

ku lindin fenomenet e bajraktarizmit dhe narcizmit politik.

## Bajraktarizmi politik: kur institucioni zëvendësohet nga individ

Bajraktarizmi politik është një formë e personalizimit të pushtetit, ku vendimmarrja nuk buron më nga institucioni, por nga individ. Në këtë model, Kushtetuta perceptohet si fleksibile, ndërsa vullneti personal si vendimtar. Por praktika kushtetuese ndërkombëtare e ka treguar qartë se ky model është i papajtueshëm me demokracinë. Shembull ilustrativ - Franca. Në periudha të ndryshme të historisë politike të France, sidomos para konsolidimit të Republikës së Tretë, përqendrimi i pushtetit në figura të forta politike krijoi paqëndrueshmëri institucionale. Vetëm me stabilizimin e rendit kushtetues modern u afirmua parimi se institucionet janë mbi individët. Shembull ilustrativ - Italia. Në Itali, periudha e Benito Mussolini tregoi qartë se kur pushteti personal dominon mbi institucionet, sistemi kushtetues shndërrohet në instrument të vullnetit individual, duke shkatërruar balancën institucionale. Në të dy rastet,

rezultati ishte i njëjtë: dobësim i shtetit juridik dhe zhvendosje e legjitimitetit nga Kushtetuta te individ.

## Narcizmi politik: deformimi i vetëdijes kushtetuese

Narcizmi politik është më i rrezikshëm se bajraktarizmi, sepse ai nuk manifestohet vetëm si përqendrim i pushtetit, por si identifikim i individit me shtetin. Në këtë model, lideri fillon të perceptojë veten si burim të vetëm të funksionimit institucional. Kjo krijon një iluzion kushtetues: se shteti ekziston për individin dhe jo individ për shtetin. Por praktika kushtetuese e demokracive të konsoliduara e refuzon këtë logjikë. Shembull ilustrativ - Shtetet e Bashkuara. Në United States, rasti Watergate scandal është shembull klasik i epërsisë së Kushtetutës mbi pushtetin personal. Dorëheqja e Richard Nixon dëshmoi se as presidenti nuk është mbi rendin kushtetues. Shembull ilustrativ - Gjermania. Në Germany, përvoja e regjimit të Adolf Hitler tregoi rrezikun ekstrem të identifikimit të shtetit me individin. Pas Luftës së Dytë Botërore, rendi kushtetues u rindërtua mbi parimin e mbrojtjes absolute të Kushtetutës nga pushteti politik,

përmes Federal Constitutional Court of Germany.

## Jurisprudenca kushtetuese si kufi ndaj arbitraritetit

Në sistemet moderne, gjykatat kushtetuese janë mekanizmi kryesor i mbrojtjes së epërsisë së Kushtetutës. Në Marbury v. Madison u vendos parimi themelor se çdo akt që bie ndesh me Kushtetutën është juridikisht i pavlefshëm. Ky vendim krijoi doktrinën e kontrollit kushtetues si garanci kundër abuzimit të pushtetit. Kjo logjikë është e përbashkët në të gjitha demokracitë kushtetuese moderne.

## Kosova dhe sfida e institucionalizimit kushtetues

Në Kosovë, sfida kryesore mbetet konsolidimi i kulturës kushtetuese, jo vetëm i strukturës institucionale. Në fazat e shtetndërtimit, rreziku më i madh nuk është mungesa e institucioneve, por dobësia e respektimit të tyre. Constitutional Court of Kosovo luan rol qendror në ruajtjen e ekuilibrit kushtetues dhe në parandalimin e interpretimit politik të normës juridike. Kur procedurat

kushtetuese zëvendësohen me vullnet politik, kur afatet dhe kompetencat relativizohen, dhe kur vendimmarrja institucionalizohet mbi bazë personale, atëherë kemi deformim të rendit kushtetues.

## Tri shtyllat që e përjashtojnë bajraktarizmin dhe narcizmin politik

Parimi i legalitetit (Legality): Çdo veprim i pushtetit duhet të ketë bazë të qartë kushtetuese. Parimi i institucionalizimit (Institutionalism): Institucionet janë të përhershme, individët janë të përkohshëm. Parimi i kufizimit të pushtetit: Pushteti ekziston vetëm brenda kufijve të vendosur nga Kushtetuta. Kushtetuta është kufiri juridik i çdo pushteti dhe garancia e vetme e rendit demokratik. Ajo ekziston për të parandaluar që vullneti personal të shndërrohet në normë dhe që institucioni të zëvendësohet nga individ. Bajraktarizmi politik dhe narcizmi institucional janë forma të devijimit nga rendi kushtetues, sepse të dyja synojnë të personalizojnë pushtetin publik. Por rendi kushtetues është i qartë: Institucioni nuk i përket individit. Shteti nuk identifikohet me liderin. Kushtetuta nuk i nënshtrohet pushtetit - pushteti i nënshtrohet Kushtetutës.

# SHQIPËRIA FIRMOS ME SHBA-në MARRËVESHJE PËR GAZIN NË VLERË PREJ 6 MILIARDË DOLLARËSH



TIRANË, 29 PRILL - Një marrëveshje prej 6 miliardë dollarësh në fushën e sigurisë energjetike është nënshkruar në Tiranë në prani të kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, dhe ambasadores së Shteteve të Bashkuara në Greqi, Kimberly Guilfoyle. Marrëveshja u firmos mes kompanisë shqiptare "Albgaz" dhe dy kompanive të mëdha ndërkombëtare, njëra amerikane e tjetra greke. Dokumenti parashikon zhvillim e Qendrës Energjetike të Vlorës dhe marrëveshjen kornizë për furnizimin me gaz të lëngshëm natyror, si hapa të rëndësishëm drejt diversifikimit të burimeve të energjisë dhe forcimit të pavarësisë energjetike, në bashkëpunim të ngushtë me Shtetet e Bashkuara si dhe ndërveprim me Greqinë. Nënshkrimi të marrëveshjes i parapriu një postim në "X" të ambasadores amerikane në Greqi, Kimberly Guilfoyle. "... në Tiranë për të avancuar agjendën energjetike të

presidentit të ShBA-së dhe për t'iu bashkuar kryeministrit Edi Rama për të marrë pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të një marrëveshjeje historike midis Shqipërisë, Venture Global dhe Aktor LNG USA për një marrëveshje 20-vjeçare për gazin e lëngshëm natyror amerikan", theksoi ambasadorja. Ajo tha se angazhimi prej 6 miliardë dollarësh forcon sigurinë energjetike dhe sigurinë kombëtare në të gjithë rajonin. "Kur Shtetet e Bashkuara, Shqipëria dhe Greqia punojnë së bashku, ky rajon është më i lidhur, më i sigurt dhe më i begatë", tha ambasadorja Guilfoyle. Marrëveshja synon ndërtimin e infrastrukturës në Vlorë për importin e gazit të lëngshëm nga ShBA-ja dhe rigazifikimin e tij për furnizimin e Evropës Jugore. Ministri i Energjisë dhe Infrastrukturës i Shqipërisë, Enea Kakaraci, gjatë ceremonisë së nënshkrimit të marrëveshjes tha se

partneriteti me ShBA-në reflekton një vizion të përbashkët për të ndërtuar një të ardhme energjetike të sigurt dhe të qëndrueshme. "Një shtyllë qendrore e këtij vizioni është zhvillimi i Qendrës Energjetike të Vlorës që është një komponent, një projekt shumë komponential që do ta ripërcaktojë rolin e Shqipërisë në këtë hartë energjetike", tha ai.

## Qendra Energjetike e Vlorës

Qendra Energjetike e Vlorës, e parashikuar për të prodhuar 97 MW energji elektrike në vit, u ndërtua në tetor të vitit 2011. Qëllimi i saj ishte të prodhonte energji elektrike nga nafta/gazi dhe ta ulte varësinë e Shqipërisë nga hidrocentralet dhe t'i zgjidhte problematikat me furnizimin me energji elektrike në kushtet e pikut të ngarkesës si dhe në kushtet e mungesës së reshjeve.

Projekti u financua nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim si dhe Banka Evropiane e Investimeve, BEI. Vlera e projektit ishte 130 milionë euro. Pas përfundimit, pati probleme teknike serioze, kryesisht me sistemin e ftohjes, dhe që nga viti 2012 ka qenë kryesisht i mbyllur. Vitet e fundit qeveria shqiptare ka diskutuar disa plane për ta riaktivizuar, por nuk ka pasur asnjë vendim. Ambasadorja Amerikane në Athinë e cilësoi Shqipërinë një partnere të palëkundur të ShBA-së dhe vend me rëndësi të jashtëzakonshme strategjike për Ballkanin dhe Evropën. "Presidenti Trump ka qenë kampion i zjarrtë i sigurisë energjetike. Vizioni dhe veprimet e tij kanë përforcuar faktin se ofrimi i një energjie të qëndrueshme forcon ShBA-në dhe aleatët tanë strategjikë. Administrata Trump e ka ngritur bashkëpunimin

energjetik si shtyllë në mbarë botën. Dhe nënshkrimi i sotëm është manifestim i prekshëm i kësaj përpjekjeje", deklaroi Guilfoyle.

Ambasadorja, gjithashtu, theksoi se ShBA-ja mbështet Ballkanin që është më i ndërlidhur, më i sigurt në aspektin energjetik dhe më i begatë dhe Shqipëria, siç tha ajo, është thelbësore për këtë vizion.

Edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, e cilësoi këtë marrëveshje me një rëndësi të jashtëzakonshme. "Vlora do të kthehet në një pikë kritike për energjinë në Evropën Juglindore. Theksoj rëndësinë e nevojës të Shqipërisë e të Greqisë për ta forcuar lidhjen tonë dhe bashkëpunimin në shumë mënyra, por posaçërisht sa i takon furnizimit me energji, prodhimit energjetik dhe rezistencës së pavarësisë energjetike. Duke pozicionuar Shqipërinë si ndërlidhëse, fluksi energjetik shkon përmes Ballkanit Perëndimor, kontribuon në stabilitetin e rajonit dhe ndikon në sigurinë energjetike të fqinjëve", tha Rama.

Kryeministri shqiptar u shpreh se partneriteti midis Shqipërisë dhe ShBA-së përçon sot një mesazh shumë të qartë se edhe vendet e vogla mund të bëhen pjesë e zgjidhjes së sfidave më të ngutshme siç është nevoja për energji.

Kosova, ndërkaq, nuk ka rrjet gazsjellësish për shpërndarjen e gazit natyror e as sistem të ndërtuar institucional për menaxhimin e këtij sektori. Por, në Strategjinë e Energjisë të Kosovës për periudhën 2022-2031 parashikohet mundësia që vendi të lidhet me rrjetet rajonale të gazit në të ardhmen.

## UP-ja lidh marrëveshje me Ministrinë e Drejtësisë për ekspertizë akademike dhe profesionale

PRISHTINË, 29 PRILL - Universiteti i Prishtinës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë për aktivitete të përbashkëta në të mirë të institucioneve publike. Sipas marrëveshjes, UP-ja do të ofrojë ekspertizë akademike e profesionale në fushat që lidhen me kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë. Personeli akademik i UP-së do të përfshihet edhe në studime, analiza, propozime, hartime të dokumenteve teknike dhe aktivitete profesionale. Marrëveshja u nënshkrua nga

rektori i Universitetit të Prishtinës, prof. Arben Hajrullahu dhe ministrja e Drejtësisë, Donika Gërvalla-Schwarz. Rektori Hajrullahu tha se pa UP-në Kosova nuk mund të bëjë hapa domethënës përpara, ndërsa ministrja Gërvalla-Schwarz shprehu bindjen se në të ardhmen vendimet dhe draftligjet e ministrisë do të jenë më të mira me përfshirjen edhe më të madhe të profesionistëve të Universitetit të Prishtinës. Në takimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes morën pjesë edhe

prorektorja për ndërkombëtarizim dhe shkëmbim akademik, prof. Rozafa Basha dhe sekretari i përgjithshëm i UP-së, Safet Thaçi, ndërsa ministrja Gërvalla erdhi e shoqëruar nga zyrtarët e kabinetit të saj, Flutura Mehmeti e Dardan Tolaj. Gjatë këtij viti drejtues të UP-së janë takuar edhe me ministrën e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fitore Pacolli-Dalipi dhe zyrtarë të ndërmarrjeve publike me qëllim të rritjes së bashkëpunimit për të mirën e përbashkët.



## Më shtrenjtë se vitin e kaluar, prodhimet bujqësore rriten për 5.8 % në tre muajt e parë të vitit

PRISHTINË, 29 PRILL - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeks të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi për tremujorin e parë (TM1) 2026, duke treguar një rritje të përgjithshme të çmimeve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025.

Sipas ASK-së, indeksi i përgjithshëm i çmimeve të prodhimeve bujqësore është rritur për 5.8 %. Rritja më e madhe është shënuar te prodhimet bimore me 7 %, ndërsa prodhimet blegtorale kanë pësuar rritje prej 4.9 %.

Të dhënat janë mbledhur nga tregjet vendore, fermat dhe burime të tjera relevante, duke përfshirë çmimet e produkteve si drithërat, perimet, pemët si dhe produktet blegtorale si qumështi, vezët dhe mjalti. ASK-ja thekson se indeksi bazohet në vitin referencë 2020

(2020=100) dhe synon t'i pasqyrojë lëvizjet e çmimeve në sektorin e bujqësisë në Kosovë. Ky zhvillim tregon një trend në rritje të kostos së prodhimit bujqësor, që mund të ndikojë edhe në çmimet përfundimtare për konsumatorët në treg.



## GUVERNATORI ISMAILI: ANGAZHIMI I BQK-së MBETET I PALËKUNDUR NË FORCIMIN E STABILITETIT FINANCIAR

**EPOKA  
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 PRILL - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) mori pjesë në "Kosova Finance Forum 2026", ku kontribuoi në mënyrë aktive përmes organizimit të një paneli të nivelit të lartë rajonal dhe pjesëmarrjes në panele dhe grupe punuese në fushëveprimin e saj institucional.

Forumi trajtoi një agjendë gjithëpërfshirëse me tema kyçe si stabiliteti financiar, kapacitetet institucionale, digjitalizimi, sigurimet, siguria kibernetike dhe ndikimi i inteligjencës artificiale në sektorin financiar.

Në fjalën hyrëse, guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili, përshëndeti organizimin e forumit, duke vlerësuar atë si një platformë të rëndësishme për shkëmbimin e përvojave dhe ideve ndërmjet institucioneve financiare, rregullatorëve dhe aktorëve të

tregut. Ai theksoi se stabiliteti dhe gjithëpërfshirja financiare, forcimi i kapaciteteve institucionale, inovacioni dhe bashkëpunimi rajonal përbëjnë shtylla thelbësore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Sipas tij, avancimi i këtyre komponentëve kërkon përkushtim të vazhdueshëm institucional, reforma strukturore të mirëfillta dhe koordinim të ngushtë ndërinstytucional. "Angazhimi i BQK-së mbetet i palëkundur në forcimin e stabilitetit financiar, rritjen e gjithëpërfshirjes dhe avancimin e inovacionit, me synim ndërtimin e një sistemi financiar modern, të sigurt dhe të përafuar me standardet evropiane. Kjo mund të arrihet përmes fuqizimit të kapaciteteve institucionale dhe thellimit të bashkëpunimit rajonal", u shpreh guvernatori Ismaili.

Gjatë fjalës së tij ai u ndal në rëndësinë e integritimit financiar



evropian, duke cilësuar atë si shtyllë strategjike për stabilitet, zhvillim institucional dhe përafrim të mëtejshëm me kornizën rregullative dhe mbikëqyrëse të Bashkimit Evropian.

Në kuadër të forumit, BQK-ja organizoi panelin e nivelit të lartë rajonal me temën "Kapaciteti institucional dhe konvergjenca me Bashkimin Evropian", i moderuar nga zëvendësguvernatorja e BQK-së,

Nesrin Shileku-Shala.

Në panel, përveç guvernatorit Ismaili, morën pjesë Sebastian Sosa, përfaqësues rajonal rezident i Fondit Monetar Ndërkombëtar për Ballkanin Perëndimor, Ivana N. Korada nga Qendra Sllovene e Ekselencës në Financa (CEF), si dhe Sergiy Maslichenko, shef i Zyrës së Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në Kosovë.

Diskutimi u fokusua në forcimin e kapaciteteve institucionale si

parakusht për konvergencën me Bashkimin Evropian, përfshirë zhvillimin e kapitalit njerëzor, rritjen e efikasitetit institucional dhe avancimin e reformave strukturore. Po ashtu, u trajtua rëndësia e harmonizimit me legjislacionin dhe standardet e BE-së, roli i institucioneve financiare ndërkombëtare në mbështetjen e reformave si dhe nevoja për bashkëpunim të zgjeruar rajonal në funksion të përshtetimit të proceseve integruar evropiane.

Pjesëmarrja e BQK-së në këtë forum reflekton angazhimin e saj proaktiv në nxitjen e dialogut profesional, shkëmbimin e praktikave më të mira dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërinstytucional, me qëllim ndërtimin e një sistemi financiar të qëndrueshëm, të sigurt dhe të integruar në nivel rajonal dhe më gjerë, në përputhje me objektivat strategjike të institucionit.

## OEK-u KËRKON VEPRIME URGJENTE PËR PËRFSHIRJEN E KOSOVËS NË PROJEKTET RAJONALE TË GAZIT

PRISHTINË, 29 PRILL - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) i ka bërë thirrje qeverisë që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për përfshirjen e vendit në projektet rajonale të gazit natyror në një kohë kur rajoni po hyn në një fazë të rëndësishme të transformimit energjetik. Sipas OEK-ut, zhvillimet e fundit në rajon, përfshirë marrëveshjen ndërmjet Bosnjë-Hercegovinës dhe Kroacisë për lidhje me terminalin "LNG Hrvatska", si

dhe marrëveshjen e re në Shqipëri për gazin e lëngshëm natyror, e mbështetur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dëshmojnë qartë se Ballkani Perëndimor po ripozicionohet në hartën energjetike të Evropës. Në këtë kontekst kjo odë ka vlerësuar se mungesa e Kosovës në këto iniciativa paraqet rrezik serioz për sigurinë energjetike dhe konkurrencën në ekonominë e vendit. "Kosova nuk ka luksin të mbetet anash,



ndërsa rajoni po ndërton infrastrukturën e së ardhmes energjetike me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Përfshirja në këto projekte është jetike për sigurinë energjetike, zhvillimin ekonomik dhe tërheqjen e investimeve strategjike", citohet të ketë thënë kryetari i OEK-ut, Lulzim Rafuna.

OEK-u ka theksuar se përfshirja e Kosovës në këto projekte duhet të bëhet në përputhje të plotë me standardet e

Bashkimit Evropian dhe me mbështetjen e partnerëve strategjikë ndërkombëtarë, duke garantuar transparencë dhe procese të hapura konkurruese.

Oda Ekonomike e Kosovës njëherësh u ka bërë thirrje institucioneve vendore që ta forcojnë dialogun me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë, në mënyrë që Kosova të sigurojë një rol aktiv në këtë moment kyç për të ardhmen energjetike të rajonit.

## Nënshkruhet marrëveshja në mes të Postës së Kosovës dhe KRU "Prishtina" për pagesën e faturave të ujit

Prishtinë, 29 prill - Kryeshefja ekzekutive e Postës së Kosovës, Nora Rraci, së bashku me bashkëpunëtorë, priti në takim kryeshefin ekzekutiv të KRU "Prishtina", Arsim Fetahu, me bashkëpunëtorë.

Gjatë këtij takimi u nënshkrua marrëveshja për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet dy kompanive, duke mundësuar

që konsumatorët e KRU "Prishtina" faturat e ujit t'i paguajnë në të gjitha zyrat e Postës së Kosovës pa provizion shtesë.

Pagesat regjistrohen automatikisht në sistem, duke siguruar shlyerje të menjëhershme të obligimeve. Posta e Kosovës, duke zgjeruar rrjetin e saj me zyra postare në

të gjithë vendin, po rrit qasjen e qytetarëve në shërbime esenciale.

Bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve u vlerësua lart nga të dyja palët, duke theksuar se kjo marrëveshje hap rrugë për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dhe zhvillimin e shërbimeve të reja në interes të qytetarëve.



# NEW YORK TIMES: PSE MONEDHA KOMBËTARE E SHBA-së BLEN AR NGA KARTELËT E DROGËS



Në këtë pikë, jemi tashmë 25 vjet në mes të një etheje për arin.

Ajo nxitet nga figura mediatike si Tucker Carlson — i cili tani po shet ar — dhe nga institucione më tradicionale si bankat qendrore dhe menaxherët e mëdhenj të investimeve në vendet e pasura. Ata ua shesin klientëve që po blejnë pothuajse për të njëjtën arsye: kanë frikë se gjithçka tjetër — aksionet, obligacionet, madje edhe dollari — mund të humbasë vlerë përballë formave të ndryshme të paqëndrueshmërisë, si lufta ose sulmet terroriste.

Por kjo ethe për arin ka pasur një efekt anësor ironik: ka çuar në një valë minierash shkatërruese që financojnë luftëra dhe sulme terroriste.

Ari financon luftën brutale civile në Sudan dhe pushtimin rus të Ukrainës. Rritja e çmimit të arit ka ndihmuar Venezuelën dhe Iranin të zbusin efektet e sanksioneve financiare. Minatorët ilegalë po shpyllëzojnë dhe ndotin Amazonën, duke helmuar njerëzit atje me merkur. Edhe grupet terroriste po hyjnë në biznesin e arit.

Shkurtimisht, njerëzit dhe qeveritë e pasura blejnë ar për të gjetur strehë nga dhuna dhe paqëndrueshmëria — dhe duke bërë këtë, ushqejnë më shumë dhunë dhe më shumë paqëndrueshmëri.

Kjo mund të tingëllojë si një lidhje abstrakte, dhe ndonjëherë është e tillë. Por ndonjëherë nuk është. Siç zbuluam unë dhe

kolegët e mi në një investigim që botuam këtë javë, ndonjëherë kjo merr formën e Monedhës Kombëtare të SHBA-së që blen dhe shet ar që vjen nga miniera të drejtuara nga kartelë droge në Kolumbi.

Minatorët e quajnë fermën La Mandinga, një emër për një shpirt të lig. Kur e vizitova së bashku me kolegë, pamë qindra minatorë që nxirrin ar duke shkatërruar tokën me zorrë uji me presion të lartë dhe ekskavatorë, si dhe duke përdorur merkur për të ndarë arin nga rëra.

Për tetë vitet e fundit, karteli më i madh i Kolumbisë, Clan del Golfo, ka kontrolluar La Mandinga-n. Askush nuk nxjerr ar pa lejen e kartelit dhe të gjithë paguajnë. (Karteli e quajti këtë një “taksë” në një deklaratë që publikoi pasi doli investigimi ynë.)

Minierat e hapura të fermës janë njëkohësisht ilegale dhe shkatërruese për mjedisin. Clan del Golfo përdor gjithashtu të ardhurat për të ruajtur kontrollin mbi territorin e tij përmes vrasjeve dhe bombardimeve.

Institucione si Monedha Kombëtare e SHBA-së (U.S. Mint) nuk supozohet të kontribuojnë në gjëra të tilla. Shitësit e mëdhenj të arit që furnizojnë qeveritë e pasura dhe investitorët kanë politika të detajuara për të mbajtur arin kriminal jashtë zinxhirit të tyre të furnizimit dhe staf të përhershëm për t'i zbatuar këto

politika. Madje, U.S. Mint është e detyruar me ligj që monedhat e saj të nivelit të investimit t'i prodhojë vetëm nga ar i nxjerrë në SHBA.

Por për dekada me radhë, ajo ka bërë sikur nuk e sheh faktin që ar nga burime të huaja — disa joetike ose ilegale — ka hyrë në uzinën e saj në West Point, Nju Jork, për t'u shkrirë dhe për t'u kthyer në monedha.

Monedha prodhon monedha me figurën e Lady Liberty duke përdorur ar nga dyqane pengjesh në Meksikë dhe Peru, si dhe nga një minierë në Kongo që është pjesërisht në pronësi të qeverisë kineze, sipas dokumenteve dhe intervistave. Një pjesë e arit të përdorur nga Mint ka ardhur edhe nga një kompani në Honduras që ka gërmuar një varrezë indigjene për të nxjerrë mineralin poshtë saj.

Mint mund ta bëjë këtë falë një lloj manovre teknike që përfshin një zinxhir të gjatë furnizuesish dhe një përpjekje për të ripërcaktuar kuptimin e “arit amerikan”, duke përfshirë edhe arin e huaj — për sa kohë që furnizuesi i arit të huaj blen gjithashtu ar amerikan.

Por ndoshta po aq e rëndësishme sa mënyra se si Mint e bën këtë është edhe arsyeja pse ajo dhe furnizuesit e saj veprojnë kështu. Çmimi i arit është tani aq i lartë saqë edhe blerësit institucionalë më prestigjiozë nuk kanë shumë nxitje për të hetuar me kujdes se nga vjen ai.

## Një biznes me marzh të ulët fitimi

Nuk është vetëm Monedha Kombëtare e SHBA-së (U.S. Mint) që angazhohet në këto praktika. Në investigimin tonë zbuluam gjithashtu se edhe Royal Canadian Mint, e cila pretendon se përdor teknologji të avancuara për të gjurmuar origjinën e arit të saj, bën të njëjtën gjë. Edhe Kanadaja po blen ar nga kartelët.

Përhapja e kësaj praktike tregon sa e vështirë është ta ndalosh.

Ari është një mall tregtar (commodity), dhe kjo e bën industrinë e arit një biznes me marzh të ulët fitimi. Rafineritë e mëdha që furnizojnë si Monedhën amerikane ashtu edhe atë kanadeze nuk mund të kërkojnë shumë më tepër sesa çmimi që mbizotëron në tregun botëror.

Në skajin tjetër të zinxhirit të furnizimit, minatorët gjysmë të zhveshur që punojnë në baltë për të nxjerrë disa gramë ar në ditë marrin rreth 90 për qind të atij çmimi botëror. Midis minatorit dhe rafinerisë ndodhen një ndërmjetës i vogël, një eksportues në Kolumbi, kompani sigurie dhe transporti, si dhe një ndërmjetës në Teksas.

Çdo hallkë merr një pjesë të vogël të fitimit; nuk mbetet shumë deri sa ari të arrijë te rafineria e madhe. Dhe meqë ata nuk mund ta rrisin çmimin,

mënyra e vetme për të fituar më shumë para është që të gjithë në këtë zinxhir — nga minatori te ndërmjetësi e deri te rafineria — të përpunojnë më shumë ar.

Në një sistem të tillë, pak janë të gatshëm të refuzojnë furnizime edhe kur ato janë të dyshimta. Dhe kështu cikli vicioz që ushqen gjithë këtë — ankthi që i shtyn njerëzit të blejnë ar, që rrit çmimin e arit, që nxit minierat ilegale, të cilat financojnë terroristë, drogë dhe diktatorë — vazhdon të rrotullohet.


Emiratet e Bashkuara Arabe njoftuan dje se do të largohen nga OPEC pas më shumë se 50 vitesh, një vendim që pritet të dobësojë ndikimin e kartelit të naftës.

United Arab Emirates, i cili prodhon rreth 12 për qind të prodhimit të përgjithshëm të OPEC-ut, kishte hedhur prej kohësh idenë e largimit nga karteli, duke u ankuar se kuotat e vendosura i kishin kufizuar eksportet e naftës. Tani pritet që vendi të rrisë prodhimin e energjisë.

Ky tronditje vjen në një moment tensioni gjeopolitik të shkaktuar nga lufta me Iran, e cila ka bërë që çmimet e naftës dhe gazit të rriten ndjeshëm. Vendimi ka tronditur rajonin, duke theksuar se Emiratet e Bashkuara Arabe, në mosmarrëveshje me Arabine Saudite po ndjekin gjithmone e me shume nje kurs te vetin.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com




**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Nis zyrtarisht garimi i vajzave në kuadër të edicionit të dytë të Ligës së Shkollave

PRISHTINË, 28 PRILL - Ka nisur zyrtarisht garimi i vajzave në kuadër të edicionit të dytë të Ligës së Shkollave që organizohet në bashkëpunim me komunën e Prishtinës dhe institucionet përkatëse të sportit shkollor. Federata e

Futbollit e Kosovës (FFK) ka bërë me dije se pas edicionit të parë të suksesshëm të Ligës së Shkollave, ky projekt zhvillimor është zgjeruar tashmë edhe me futbollin e vajzave, me synim për ta rritur përfshirjen e tyre aktive

në sportin shkollor dhe duke krijuar mundësi të barabarta për talentet e reja. "Ky aktivitet është gjithashtu në përputhje me një nga shtyllat kryesore të strategjisë së FFK-së, barazinë gjinore në futboll, duke synuar

fuqizimin e vajzave dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në të gjitha nivelet e garave. Suksese për të gjitha ekipet pjesëmarrëse dhe urojmë për një tjetër një edicion të suksesshëm garash!", ka njoftuar FFK-ja.



## LEON AVDULLAHU VAZHDON KONTRATËN ME HOFFENHEIMIN

HOFFENHEIM, 28 DHJETOR - Pas mbrojtësit Alban Hajdari, edhe mesfushori Leon Avdullahu ka vazhduar kontratën me skuadrën e Hoffenheimit. Ekipi i Bundesligës së Gjermanisë të mërkurën ka zyrtarizuar vazhdimin e bashkëpunimit me mesfushorin e Kombëtares së Kosovës. Me rinovimin e kontratës, Avdullahu do të jetë pjesë e Hoffenheimit deri në verën e vitit 2031 pasi kontrata paraprake i skadonte në vitin

2029. Drejtori sportiv i Hoffenheimit, Andreas Schicker, ka thënë se në klub janë shumë të kënaqur që kanë rinovuar kontratën me Avdullahun, të cilin e ka vlerësuar lart për vizionin e tij të lojës, që i përshtatet tërësisht skuadrës. Sipas tij, Avdullahu është dhe mbetet një prej lojtarëve kyçë të Hoffenheimit për të ardhmen, duke e quajtur figurë kryesore të skuadrës. Ndërkohë, Avdullahu është

shprehur tejet i lumtur që do të vazhdojë të jetë pjesë integrale e Hoffenheimit dhe se dëshiron që të kontribuojë në suksesin e ekipit dhe klubit. Avdullahu në verën e vitit të shkuar iu bashkua Hoffenheimit për 10 milionë euro nga Baseli, ndërsa këtë sezon në 32 paraqitje në të gjitha garat ka regjistruar një asistim. Gjithashtu, Avdullahu ka edhe 5 paraqitje me Kombëtaren e Kosovës për të cilën debutoi në muajin shtator të vitit të shkuar.



## EVERTONI KËRKON HUAZIMIN E ZHEGROVËS

TORINO, 28 PRILL - Edon Zhegrova, megjithatë, mund të largohet nga Juventusit, por vetëm në formë huazimi, kanë raportuar mediumet në Angli. Është bërë me dije se Evertoni është i interesuar ta huazojë Zhegrovën për sezonin e ardhshëm, duke pasur parasysh se Juventusit nuk është i sigurt në shitjen e plotë të 27-vjeçarit. Trajneri Luciano Spalletti ende nuk ka vendosur nëse do ta mbajë në ekip Zhegrovën për sezonin e ri dhe gjasat janë të mëdha që ta aprovojë huazimin e tij njëvjeçar në Angli. Zhegrova ka kontratë me Juventusin deri në verën e vitit 2030, por këtë sezon ka pasur pak minuta të dispozicionit, ku vetëm në një ndeshje ishte startues te skuadra italiane. Prejse i është bashkuar Juventusit prej Lilet verën e



shkuar, Zhegrova në total ka regjistruar 23 paraqitje në të gjitha garat për "Zonjën e Vjetër". Krahas Evertonit,

situatën e Zhegrovës te Juventusit po e monitorojnë edhe Beshktashi, Marseille e Monaco.

## CHELSEA I PRIN GARËS PËR FISNIK ASLLANIN

HOFFENHEIMIN, 28 PRILL - Chelsea po shihet si ekip favorit për t'i siguruar shërbimet e Fisnik Asllanit përpara skuadrave të tjera që gjithashtu janë në garë për sulmuesin e Kosovës. Është raportuar në medie ndërkombëtare se Chelsea po i prin kësaj gare, duke lënë pas vetes Barcelonën, Tottenhamin, Aston Villan e Borussia Dortmundin. Ekipi nga Premierë Liga ka njoftuar Hoffenheimin se është gati të paguajë deri në 35 milionë euro për kartonin e Asllanit, i cili në verë pritet të largohet nga skuadra gjermane. 23-vjeçari ka kontratë deri në vitin 2029 me



Hoffenheimin, por edhe një klauzolë lirimi në vlerë prej 30 milionë eurosh që lejon largimin e Asllanit. Asllani këtë sezon ka shpërthyer te Hoffenheimi, ku në 32 ndeshje të luajtura në të gjitha garat, ka shënuar 11 gola dhe ka bërë 9 asistime.

## Muriqi nominohet për formacionin e sezonit në La Liga

Mallorca, 28 prill - Sulmuesi i Kombëtares së Kosovës, Vedat Muriqi, po kalon një nga sezonet më të mira të karrierës së tij në futbollin spanjoll me fanellën e RCD Mallorca. "Pirati dardan" ka arritur të

realizojë deri më tani 21 gola në kampionat, duke u shndërruar në një nga sulmuesit më efikas të sezonit. Me edhe pesë ndeshje të mbetura deri në përfundim të edicionit, ai ka mundësi ta

rrisë edhe më tej këtë bilanc mbresëlënës. Si rezultat i paraqitjeve të tij, Muriqi është nominuar për formacionin më të mirë të sezonit në La Liga, një vlerësim që reflekton ndikimin e tij të madh në

fushë gjatë këtij edicioni. Lajmi është bërë me dije nga vetë klubi i Mallorcës përmes një postimi në platformën "X", ku është konfirmuar nominimi i sulmuesit nga Kosova.



**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Metro Studio” L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811554973 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Metro Studio” L.L.C. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811554973 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “Metro Studio” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811554973 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Bler Farm” SH.P.K. me seli në Malishevë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810153122 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Bler Farm” D.O.O. Malishevo donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810153122 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “Bler Farm” L.L.C. with headquarters Malishevë, has come to the decision to quit its business: 810153122 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURISIT**

Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 16.01.2026 për vendin e punës:

**I. Pozita:** Zyrtar për Kominikim me Publikun  
**Numri i pozitave:** Një (1)  
**Numri i referencës:** RZKP/ZKA/12-15/25

Konkursi anulohet bazuar në Vendimin nr. 659 të Komisionit të Ankesave në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Prishtinë, 30.04.2026

Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

**SAOPŠTENJE O PONIŠTAJU KONKURSA**

Nacionalna kancelarija revizije saopštava da se poništava konkurs za sledeće radno mesto objavljen u dva lokalna medija, na zvaničnoj veb stranici i na oglasnoj tabli Nacionalne kancelarije revizije dana 16.01.2026. godine:

**I. Pozicija:** Službenik za odnose s javnošću  
**Broj pozicija:** Jedna (1)  
**Broj reference:** RZKP/ZKA/12-15/25

Konkurs se poništava na osnovu Odluke br. 659 Žalbene komisije Nacionalne kancelarije revizije.

Priština, 30.4.2026.goidne

Odeljenje za upravljanje ljudskim resursima

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Ismajl Sadiki shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës sh.m.u.l nga kl 6-9 në Mamush “Anadol” Mamush.
- Albrim Sylja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Andi Firzi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11 marsi” Prizren.
- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “Fehmi Agani” Baçelor i Edukimit Fillor.
- Francez Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfm u “ Zef Lush Marku” Velezhe.
- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.
- Kristijan Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IXshfm u “ Zef Lush Marku” Velezhe.
- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Mensur Morina shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Veton Muhadri shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë si dhe dëftesat e kl. 10.11.12.
- Kreshnik Berisha B.I. Rogovë Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues: 812216259 të lëshuar nga ARBK.
- Beqir Cenaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Aida Murselaj Çiflak Rahovec shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “Fehmi Agani” Gjakovë me numër 200102037.
- Bedri Smolica shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Muharrem Miftari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme “Silvira Tomazini” gjimnazi “Frang Bardhi” Mitrovicë.
- Buna Sada shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

Ziraat Bank

ZIRAAT BANK KOSOVA SH.A

Bilanci i gjendjes me : 31.03.2026	Euro'000	Euro'000
	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
<b>Pasurite</b>		
Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në	30,823	38,720
Kërkesat ndaj bankave	1,239	936
Plasmanet ne Institucionet kreditore	4,000	9,003
Kreditë dhe paradhënie ndaj klientëve	97,838	98,866
Investimet në letra me vlerë	6,321	6,284
Patundshmëritë dhe pajisjet	1,743	1,885
Pasuritë e paprekshme	350	344
Pasuritë tatimore të shtyra	356	356
Pasuritë tjera	470	580
<b>Gjithsej pasuritë</b>	<b>143,139</b>	<b>156,974</b>
<b>Detyrimet</b>		
Detyrimet ndaj bankave	14,057	6,030
Depozitat e klientëve	106,638	128,252
Fondet tjera të huazuara	-	-
Detyrimet tatimore të shtyra	-	-
Detyrimet tjera	1,023	1,161
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<b>121,718</b>	<b>135,443</b>
<b>Ekuiteti i aksionarëve</b>		
Kapitali aksionar	25,000	25,000
Rezervat e kapitalit	-	-
Fitimi i mbajtur	951	3,579
Fitimi/(humbja) i vitit aktual	4,530	110
Përbërësit tjerë të ekuitetit	-	-
<b>Gjithsej ekuiteti i aksionarëve</b>	<b>21,421</b>	<b>21,531</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>143,139</b>	<b>156,974</b>

Ziraat Bank

ZIRAAT BANK KOSOVA SH.A

Pasqyra e të ardhurave me: 31.03.2026	Euro'000	Euro'000
	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Të hyrat nga interesi	7,783	1,842
Shpenzimet e interesit	-	889
<b>Neto të hyrat nga interesi</b>	<b>4,321</b>	<b>953</b>
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	605	140
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	-	155
<b>Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet</b>	<b>267</b>	<b>14</b>
Neto të hyrat tjera	162	12
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	-	991
<b>Gjithsej të hyrat</b>	<b>466</b>	<b>40</b>
Provizionet për humbjet nga kreditë	-	161
Provizionet tjera	411	11
<b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>	<b>-</b>	<b>110</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
Shpenzimet e tatimit të shtyer	234	-
<b>Fitimi/(humbja) neto</b>	<b>-</b>	<b>110</b>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	<b>-</b>	<b>110</b>





## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Titulli i vendit të punës:** Zyrtar/e i/e Lartë për analizë dhe planifikim të përmbylljes (Resolution)  
**Grada:** P05  
**Kohëzgjatja e punësimit:** me afat të pacaktuar  
**Departamenti:** Departamenti i Rimëkëmbjes dhe Përmbylljes  
**Divizioni:** Divizioni për Planifikim, Strategji dhe Standardizim  
**I raporton:** Udhëheqësit të Divizionit për Planifikim, Strategji dhe Standardizim

### Qëllimi i pozitës

Zyrtari i Lartë për Planifikim dhe Analizë të Përmbylljes (Resolution) është përgjegjës për mbledhjen dhe analizimin e raporteve financiare në funksion të planifikimit të përmbylljes së bankave, përgatitjen dhe përditësimin e planeve të përmbylljes, përllogaritjen dhe monitorimin e kërkesave minimale për kapital dhe detyrime të pranueshme (MREL), vlerësimin e përmbyllshmërisë së bankave si dhe për kontribimin në zhvillimin e strategjive të përmbylljes, metodologjive dhe standardeve analitike të nevojshme për zbatimin efektiv të përmbylljes së bankave (Bank Resolution).

### Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore:

- Mbledh, shqyrton dhe analizon raportet financiare të pranuar nga bankat dhe burime të tjera relevante për përgatitjen e planeve të përmbylljes.
- Analizon pasqyrat financiare të bankave, raportet mbikëqyrëse dhe të dhënat tjera relevante për planifikim të përmbylljes.
- Analizon karakteristikat financiare, operacionale dhe strukturore të bankave për të vlerësuar zbatimin e instrumenteve të përmbylljes ndaj tyre.
- Kryen përgatitjen dhe përditësimin e rregullt të planeve të përmbylljes për bankat dhe, kur është e zbatueshme, për grupet bankare.
- Mbështet identifikimin dhe zhvillimin e strategjive dhe instrumenteve të përshtatshme të përmbylljes për bankat individuale.
- Kryen vlerësime të përmbyllshmërisë së bankave për të identifikuar pengesat e mundshme për zbatimin efektiv të përmbylljes.
- Vlerëson dhe monitoron kërkesat minimale për kapital dhe detyrime të pranueshme (MREL) që duhet të mbajë banka.
- Kryen analiza mbështetëse për vlerësimin e aseteve dhe detyrimeve të bankave në kontekstin e planifikimit të përmbylljes.
- Përllogarit nivelin e kontributeve vjetore të bankave për Fondin e Përmbylljes dhe, kur është e nevojshme, kryen përllogaritjen e kontributeve të jashtëzakonshme.
- Kontribuon në hartimin dhe zhvillimin e rregulloreve, procedurave, udhëzimeve, standardeve dhe metodologjive që lidhen me procesin e përmbylljes së bankave.
- Bashkëpunon me Departamentin e Mbikëqyrjes Bankare për çështje që lidhen me planifikimin dhe vlerësimin e përmbylljes.
- Mbështet bashkëpunimin me institucionet vendore dhe Fondin për Sigurimin e Depozitave, kur është e nevojshme, për planifikimin e përmbylljes.
- Mbështet koordinimin dhe bashkëpunimin me autoritetet të huaja të përmbylljes dhe organizata ndërkombëtare për qëllime të përmbylljes.
- Kryen analiza dhe studime të ndryshme për të mbështetur arritjen e objektivave të përmbylljes.
- Përgatit raporte analitike, materiale informuese dhe rekomandime lidhur me planifikimin dhe strategjitë e përmbylljes.
- Merr pjesë në aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe kontribuon në forcimin e kapaciteteve analitike dhe teknike të Divizionit.
- Kryen detyra të tjera sipas kërkesës së Udhëheqësit të Divizionit dhe Drejtorit të Departamentit.

### Njohuritë akademike dhe profesionale të kërkuara:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, drejtësisë, shkencave kompjuterike, teknike, matematikës apo në fusha të tjera të cilat ndërlidhen me përgjegjësitë e njësisë organizative, sipas përshkrimit të publikuar në uebfaqen e BQK-së në linkun: [Departamentet e Guvernatorit - BQK](#).
- Preferohet të ketë certifikime në fushat që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e vendit të punës.
- Diploma ose certifikata profesionale ekuivalente me nivelin e kontabilistit të certifikuar është përparësi.
- Njohja e gjuhës angleze në nivel të avancuar është e obligueshme dhe do të vlerësohet gjatë procesit të rekrutimit.

### Përvoja profesionale e kërkuar:

- Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale në sektor financiar ose përvojë profesionale në risk, auditim, financa dhe që ndërlidhet me përgjegjësitë dhe detyrat e njësisë organizative, sipas përshkrimit të publikuar në uebfaqen e BQK-së në linkun: [Departamentet e Guvernatorit - BQK](#).

### Kërkesat e posaçme:

- Shkathësi të avancuara analitike dhe kuantitative, të nevojshme për analizimin e pasqyrave financiare të bankave.
- Aftësi analitike të gjykimit për të vlerësuar dhe zbatuar legjislacionin në fuqi dhe për të rekomanduar veprime të mëtejshme.
- Njohuri të kuadrut ligjor, rregulloret dhe standardet e aplikueshme ndaj bankave.
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur, në mënyrë efektive në ekip si dhe për të mirëmbajtur marrëdhënie të mira profesionale me kolegët dhe me palët e jashtme.
- Aftësi për të punuar nën presion dhe për të përmbyllur afatet e caktuara kohore.
- Aftësi për të menaxhuar detyra komplekse analitike si dhe vëmendje të lartë ndaj detajeve.
- Aftësi të mira të komunikimit me shkrim dhe me gojë.
- Njohuri të shkëlqyera në përdorimin e sistemeve kompjuterike, MS Office e të ngjashme.
- Person me etikë të lartë dhe i aftë në ruajtjen e fshehtësisë profesionale.

### Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim.** Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të Formularit zyrtar të BQK-së gjatë aplikimit online nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes.
- Letrën përcjellëse (motivuese)** e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur posaçërisht për pozitën për të cilën aplikojnë; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim.
- Dëshmi mbi përvojën e punës, që mbulojnë së paku tre (3) vite përvojë pune** (kopje të kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse,** e cila mbulon së paku tre (3) vite përvojë pune, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raportin nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht.
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomatat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nosifikuar zyrtarisht nga ana e MASHT-it.
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

### Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim **15 maj 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.



## OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

**Naziv radnog mesta:** Viši službenik/ca za analizu i planiranje sanacije (Resolution)  
**Stepen:** P05  
**Trajanje zaposlenja:** na neodređeno vreme  
**Departman:** Departman za oporavak i sanaciju  
**Divizija:** Divizija za planiranje, strategiju i standardizaciju  
**Izveštava:** Rukovodiocu Divizije za planiranje, strategiju i standardizaciju

### Svrha radnog mesta

Viši službenik/ca za planiranje i analizu sanacije (Resolution) odgovoran/na je za prikupljanje i analizu finansijskih izveštaja u funkciji planiranja sanacije banaka, izradu i ažuriranje planova sanacije, obračun i praćenje minimalnih zahteva za kapital i prihvatljive obaveze (MREL), procenu mogućnosti sanacije banaka, kao i za doprinos razvoju strategija sanacije, metodologija i analitičkih standarda neophodnih za efikasnu primenu sanacije banaka (Bank Resolution).

### Glavne dužnosti i odgovornosti:

- Prikuplja, razmatra i analizira finansijske izveštaje dostavljene od strane banaka i drugih relevantnih izvora za potrebe izrade planova sanacije.
- Analizira finansijske izveštaje banaka, nadzorne izveštaje i druge relevantne podatke za planiranje sanacije.
- Analizira finansijske, operativne i strukturne karakteristike banaka radi procene primene instrumenata sanacije na njih.
- Vrši izradu i redovno ažuriranje planova sanacije za banke i, kada je primenljivo, za bankarske grupe.
- Podržava identifikaciju i razvoj odgovarajućih strategija i instrumenata sanacije za pojedinačne banke.
- Sprovodi procene mogućnosti sanacije banaka (resolvability) radi identifikovanja potencijalnih prepreka za efikasnu primenu sanacije.
- Procenjuje i prati minimalne zahteve za kapital i prihvatljive obaveze (MREL) koje banka treba da održava.
- Sprovodi prateće analize za procenu aktive i pasive banaka u kontekstu planiranja sanacije.
- Obračunava nivo godišnjih doprinosa banaka Fondu za sanaciju i, kada je potrebno, vrši obračun vanrednih doprinosa.
- Doprinosi izradi i razvoju regulative, procedura, smernica, standarda i metodologija koje se odnose na proces sanacije banaka.
- Saraduje sa Departmanom za nadzor banaka po pitanjima vezanim za planiranje i procenu sanacije.
- Podržava saradnju sa domaćim institucijama i Fondom za osiguranje depozita, kada je potrebno, u vezi sa planiranjem sanacije.
- Podržava koordinaciju i saradnju sa stranim rezolucionim organima i međunarodnim organizacijama u svrhu sanacije.
- Sprovodi različite analize i studije radi podrške ostvarivanju ciljeva sanacije.
- Priprema analitičke izveštaje, informativne materijale i preporuke u vezi sa planiranjem i strategijama sanacije.
- Učestvuje u aktivnostima za unapređenje profesionalnih kapaciteta i doprinosi jačanju analitičkih i tehničkih kapaciteta Divizije.
- Obavlja i druge poslove po nalogu rukovodioca Divizije i direktora Departmana.

### Potrebna akademska i stručna znanja:

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, prava, računarskih nauka, tehničkih nauka, matematike ili drugih oblasti koje su povezane sa odgovornostima organizacione jedinice, u skladu sa opisom objavljenim na veb-stranici CBK na sledećem linku: [Departamentet e Guvernatorit - BQK](#).
- Poželjno je posedovanje sertifikata iz oblasti koje su povezane sa dužnostima i odgovornostima radnog mesta.
- Diploma ili profesionalni sertifikat ekvivalentan nivou ovlašćenog računovođe predstavlja prednost.
- Znanje engleskog jezika na naprednom nivou je obavezno i biće ocenjavano tokom procesa regrutacije.

### Zahtevano radno iskustvo:

- Da ima najmanje tri (3) godine radnog iskustva u finansijskom sektoru ili profesionalno iskustvo u oblasti rizika, revizije, finansija koje je povezano sa odgovornostima i dužnostima organizacione jedinice, u skladu sa opisom objavljenim na veb-stranici CBK na sledećem linku: [Departamentet e Guvernatorit - BQK](#).

### Posebni zahtevi:

- Napredne analitičke i kvantitativne veštine, neophodne za analizu finansijskih izveštaja banaka.
- Analitičke sposobnosti prosuđivanja za procenu i primenu važećeg zakonodavstva i davanje preporuka za dalje postupanje.
- Poznavanje pravnog okvira, propisa i standarda primenljivih na banke.
- Sposobnost za samostalan rad, efikasan rad u timu, kao i održavanje dobrih profesionalnih odnosa sa kolegama i eksternim stranama.
- Sposobnost rada pod pritiskom i poštovanja utvrđenih rokova.
- Sposobnost upravljanja složenim analitičkim zadacima uz visok nivo pažnje na detalje.
- Dobre komunikacione veštine, usmene i pisane.
- Odlično poznavanje rada na računaru, uključujući MS Office i slične programe.
- Visok nivo profesionalne etike i sposobnost čuvanja poverljivih informacija.

### Svi kandidati trebaju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični formular CBK za prijavu.** Prijave sa nepotpunim ili netačno popunjenim zvaničnim formularom CBK tokom onlajn prijave neće biti razmatrane i rezultiraće diskvalifikacijom u procesu selekcije.
- Motivaciono pismo (propratno pismo)** koje mora biti adresirano i posebno pripremljeno za radno mesto za koje se konkurise; u suprotnom, prijava neće biti razmatrana.
- Dokaz o radnom iskustvu, koji obuhvata najmanje tri (3) godine radnog iskustva** (kopije ugovora ili potvrda od poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe kao dokaz o obavljanoj poziciji i radnom iskustvu, bez narušavanja relevantnih propisa o zaštiti ličnih podataka).
- Izveštaj Kosovskog penzionog štednog fonda (Trusta) za relevantni period,** koji pokriva najmanje tri (3) godine radnog iskustva, ili poreska potvrda Poreske administracije (PAK) kada izveštaj Trusta nije pravno primenljiv.
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosova moraju biti zvanično priznate/nosifikovane od strane MONT-a.
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za potvrđivanje državljanstva Kosova.

### Procedura podnošenja prijave:

- Rok za prijavu je **15 Maj 2026**.
- Prijava se može podneti onlajn (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a. Ostali obrasci prijave neće biti razmatrani.

**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

